

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 40-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 24.10.2024**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr. Metodija Jançeski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Dimitar Tanurov, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, mr. Gorjan Sheqerinov, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë: /**

Z.Petrushevski hapi seancën e 40-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në orën 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri me 6 vota „pro“, miratoi si vijon:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 39-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 17.10.2024.
2. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike operatorit Drim Sat nga Gostivari për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike operatorit Nafi dhe Beko nga Gostivari për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike operatorit MTEL nga Shkupi për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.
5. Të ndryshme.

## **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 39-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 17.10.2024, me tekstin e propozuar.

## **Pikat 2, 3 dhe 4**

Z. Trajçevski tha se nëse Këshilli pajtohet, do të bëjë një hyrje për tre vërejtjet publike të propozuara, për Drim Sat nga Gostivari, Nafi dhe Beko nga Gostivari dhe MTEL nga Shkupi, për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV. Shpjegoi se nga mbikëqyrja e rregullt programore tek të tre operatorët është konstatuar se kanë ritransmetuar shërbime programore që nuk mbulohen me çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Ai e informoi Këshillin se ka pasur bisedë telefonike me drejtorin e operatorit MTEL nga Shkupi, i cili ka shpjeguar se arsyeja për ritransmetim të kanaleve maqedonase pa çertifikatën për regjistrim është për shkak se deri më tani Marrëveshja është nënshkruar me MTEL, dhe marrëveshja e ardhshme do të nënshkruhet me MTC direkt në Beograd. Ata shpjeguan se në afat prej 10 ditësh ky problem teknik do të tejkalohet, përkatësisht do të nënshkruhen kontrata me kanalet maqedonase dhe MTC direkt në Serbi. Ai ka thënë se shkelja e këtij neni të Ligjit nga të tre operatorët është bërë për herë të parë këtë vit dhe për këtë arsye propozohet që të shqiptohet masë vërejtje publike, dhe detyrohen menjëherë që pas pranimi të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizojnë punën e tyre me LSHMAAV dhe Sektori të kryej mbikëqyrje kontrolli.

### *Votimi për Pikën 2*

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.11-4299/1 datë 17.10.2024 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë për telekomunikacion, tregti dhe shërbime DRIM SAT IPTV SHPKNJP eksport-import fsh. Çergan-Gostivar t'i shqipton masën vërejtje publike për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, detyrohet menjëherë pas pranimi të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizon punën e tij me LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja është konstatuar se Shoqëria për telekomunikacion, tregti dhe shërbime DRIM SAT IPTV SHPKNJP eksport-import fsh. Çergan-Gostivar, që sipas notifikacionit nga AKE mund të kryejë veprimtarinë në teritorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me datë 17.10.2024 për përdoruesit e tij ka ritransmetuar shërbimin programor „Hit Mix Music“, që nuk mbulohet me çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV.

Sektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike operatorit në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

### Votimi për Pikën 3

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të rregullt programore, nr.11-4298/1 datë 17.10.2024 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë së shërbimit tregtar të prodhimit NAFI DHE BEKO SHPKNJP eksport-import Gostivar t'i shqipton masën vërejtje publike për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, detyrohet menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizon punën e tij me LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja u konstatua se Shoqëria e shërbimit tregtar të prodhimit NAFI DHE BEKO SHPKNJP eksport-import Gostivar, që sipas notifikacionit të AKE, mund të kryejë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me datë 17.10.2024 për përdoruesit e tij ka ritransmetuar shërbimin programor „TV Kanal 5“ që nuk mbulohet me çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV.

Sektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike operatorit në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryer mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

### Votimi për Pikën 4

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të rregullt programore, nr.11-4307/1 datë 18.10.2024 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup t'i shqipton masën vërejtje publike për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022 detyrohet që menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizon punën e tij me LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja u konstatua se Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, që sipas notifikacionit të AKE mund të kryen veprimtari në territorin e RMV-së, me datë 16.10.2024 për përdoruesit e tij ka ritransmetuar shërbimet programore „Telma“, „Alfa TV“, „Kanal 5“, „Alsat M“, „Kompani 21“, „24 Vesti“, „News Max Balkans“, „Diva“, „Nickelodeon“, „Nickelodeon Junior“, „RTL“, „RTL II“ dhe „RTL Croatia“, që nuk mbulohen me çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV.

Sektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike operatorit në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

#### **Pika 5**

#### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**